



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:186266

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02403872

**P. nr. 106/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. A. nga fsh. . . K Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 315 lidhur me par.1-1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-DP ne Gjakovë, PP/II.nr.1589/20 të datës 24.02.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **15.11.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi, te dëmtuarit S. A. si dhe të akuzuarit, ndërsa me datën 16.11.2021 morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. A.** nga fsh. . . K Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës Z. e gjinisë M., data e lindjes . . ., ka te kryer V kl të shkollës fillore, punëtor fizik, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve, me nr.ID . . .

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse :**

**-me dt.09.10.2020, rreth orës 14:00, në fsh. . . Komuna e Gjakovës, në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri B. A., me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit-babait të tij S. A., në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar kohen deri sa i dëmtuari ishte në shtëpinë e të pandehurit, duke ngrenë bukë, pandehuri largohet nga aty duke shkuar në dhomën gjumit të dëmtuarit dhe me forcë hap derën e dhomës së fjetjes të dëmtuarit dhe depërton brenda, e poshtë divanit ia vjedh të hollat në shumë prej 150 euro dhe gjëra ushqimore ne frigorifer në vlerë rreth 60 Euro, dhe largohet në drejtim të panjohur, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton dem material ne vlere prej 210 euro.**

**-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.**

**Andaj,**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49,69 ,70, neni 315 par.1-1.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

**DENIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një ) viti** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy ) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 100(një qind ) euro të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi , në kohëzgjatje prej **5(pesë) ditësh** , duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet).-€**.

I dëmtuari S. A. nga fsh. . . . K Gjakovë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.1589/20 të datës 24.02.2021, ndaj të akuzuarit B. A. nga fshati . . .Komuna Gjakovë, për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e rend nga neni 315 par.1 lidhur me par.1.1 , dhe ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të gjykohej sipas Kodit Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2021 , përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Nazmi Krasniqi , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP/II.1589/20 të datës 24.02.2021

I akuzuari B. A. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar ,lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favorët juridike të pranimit të fajësisë, shtojë se me pranimin e fajësisë jam përduruar për veprën e kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike , ku kam shkuar në dhomën e babait dhe aty kam vërejtur se në frizë kishte gjera ushqimore e po ashtu edhe paratë ishin çantën e tij poshtë divanit shuma nuk me kujtohet ,ku me ato para kam blerë gjera ushqimore për veti dhe familjen ,pasi që hanim bashku në të njëjtën shtëpi në atë kohë , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet e mia ,tani nuk jam duke jetuar me të dëmtuarin pasi që shoqata “. . .“ ma ka ndërtuar shtëpinë ndaras nga shtëpia e prindit ku unë jetoj me familjen time të ngushtë , andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme ,kërkim falje nga i dëmtuari, gjendjen e dobët ekonomike, të me shqiptojë një dënim me të butë .

I dëmtuari S. A. deklaroi se i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe kërkojë kompensim demi .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari B. A. pasi që të njëjtin pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë të sqaruara edhe nga ana gjykatës ,e duke marr parasysh se aktakuza ka mbështetje në provat personale dhe material në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale me të cilat ngarkohet i akuzuari ,

Në shqyrtimin fillestar gjykatara ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. A. : **-me dt.09.10.2020, rreth orës 14:00, në fsh.. . Komuna e Gjakovës, në shtëpinë e tyre të përbashkët**, i pandehuri B. A., me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit-babait të tij S. A., në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar kohën deri sa i dëmtuari ishte në shtëpinë e të pandehurit, duke ngrënë bukë, pandehuri largohet nga aty duke shkuar në dhomën gjumit të dëmtuarit dhe me forcë hap derën e dhomës së fjetjes të dëmtuarit dhe depërton brenda, e poshtë divanit ia vjedh të hollat në shumë prej 150 euro dhe gjëra ushqimore ne frigorifer në vlerë rreth 60 Euro, dhe largohet në drejtim të panjohur, me ç 'rast të dëmtuarit i shkakton dem material ne vlere prej 210 euro.

**-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari , pranimit i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në diapozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana renduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh personalitetin e tij se i njëjti është baba i 3 fëmijëve , pranimit e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte e të akuzuarit ne gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm ,kërkim falja nga i dëmtuari , gjendjen e tij të dobët ekonomike Ne këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm ,korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, të cilat rrethana ndikuan që gjykata duke pasur parasysh edhe mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale të kryer në shtëpinë e tyre të përbashkët ku pos të hollave të dëmtuarit –prindit të tij i merr edhe gjëra ushqimore siç është përshkruar në dispozitiv , rrezikshmërinë e saj, ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit bazuar në nenin 72 par.1 nënpar.1.3 te KPRK-së, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një) viti** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin **prej 2(dy) viteve** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale **si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njëqind ) euro**, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e

detyrimit për respektimin e ligjit. dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463par.2 te KPP-ës., ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm, të kërkesës pasurore juridike .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë në shumë prej 30,00 € në emër të paushallit gjyqësor ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.106/21 datë 16.11.2021.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatë së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate

Numri i lëndës: 2020:186266  
Datë: 16.11.2021  
Numri i dokumentit: 02403872